



Bulevardi. Gjergj Fishta
Tirane, Shqipëri



Tel +355 4 2225581
Fax +355 4 2225581
info@ost.al
www.ost.al

Nr. DEF Prot

Tiranë, më / / 2013

Drejtuar: Z. Sokol Ramadani

Kryetari i ERE

Subjekti: Mbi aplikimin në ERE për axhustimin e tarifave.

I nderuar Z. Ramadani,

Bazuar në Metodologjinë e Tarifave, e cila parashikon axhustimin e tyre, OST sh.a. paraqet pranë jush të dhënat për disa tregues kryesorë të aktivitetit. Për llogaritjen e këtyre treguesve janë mbajtur parasysh të dhënat faktive për 8 mujorin e vitit 2012, si dhe realizimi i pritshëm për 4 mujorin III të vitit 2012. Të dhënat për energjinë e transmetuar janë, si më poshtë:

kWh				
Nr	Emërtimi	8 mujori faktik	I pritshmi 4 mujori III	Viti 2012
1	Transmetim energji elektrike	4,769,210,302	2,368,402,892	7,137,613,194

Vlera e investimeve të parashikuara për vitin 2012 në aplikimin e bërë nga OST pranë ERE-s, ishte 9 miliard lekë. Në bazë të të dhënave të realizimit të projekteve të përfunduara me donatorët e huaj, si dhe të investimeve me fondet e veta vlera e tyre parashikohet të realizohet në 5,414 milion lekë. Analitikisht e shprehur, si më poshtë:

INVESTIMET QË DO TË KAPITALIZOHEN GJATË VITIT 2012

Nr	Projekti	Vlera (Lekë 000)	Data/afati i pritshëm / faktik për përfundimin e projektit
1	Rehabilitimi i Nënstacioneve Tirana 1, Fier, Elbasan 1.	2,828,795	6-mujori I 2012
2	Rehabilitimi i Nënstacioneve Burrel dhe Elbasan 2	1,216,096	31.12.2012

3	Linja 400 kV Tiranë- Elbasan (materiale për linjat 220 kV, shtylla, përcjellës dhe OPGW)	450,000	31.12.2012
4	Investimet me fondet e veta	918,939	31.12.2012
	Totali	5,413,830	31.12.2012

Niveli i ulët i arkëtimeve për faturat e vitit 2012 në masën prej 55 % nga shoqëria CEZ Shpërndarje, ka penguar realizimin e disa prej projekteve të rëndësishme, me fondet e OST-së.

Përsa i përket pagesës që OST duhet të kryejë për CBT-në për vitin 2012, mund të themi se, nga njoftimet e mbërritura për 5 mujorin e vitit 2012 vlera që duhet të paguajë OST-ja është rreth 1.5 milion euro ose 210 milion lekë; për vitin 2012 llogaritet të paguhet në total një vlerë prej rreth 3 milion euro.

Në aplikimin e bërë për tarifën e viteve 2012-2014, shpenzimi për pagesë CBT-je ishte parashikuar në vlerën 250 milion lekë.

Nisur nga sa parashtruar më sipër shtesa e shpenzimeve për zërin "pagesë për CBT" llogaritet në vlerën 170 milion lekë.

Për llogaritjen e mesatares së ponderuar të kostos së borxhit nga OST gjatë aplikimit ka marrë parasysh normat vjetore të "libor" dhe "euribor".

Aktualisht norma e interesit vjetor për vendosjen e depozitave është 7.79 %, kundrejt 7.67 % e përdorur në aplikimin për tarifë transmetimi.

Mbetemi të hapur për çdo informacion shtesë.

Ju faleminderit,

Administratori i OST sh.a

Arben Ibroja